



**Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim**

**Raport Vjetor 2015**

## I. PËRMBLEDHJE

Viti 2015 shënon vitin e parë të ciklit të dytë të certifikimit për mjekët, farmacistët e dentistët. Gjithashtu, këtë vit u bënë ndryshimet ligjore, sipas të cilave edhe infermierët, mamitë dhe ndihmësfarmacistët bëhen pjesë e programit në vitin 2016.

Gjatë vitit 2015 janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm aktivitetesh të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë. Numri i këtyre aktiviteteve që kanë aplikuar për tu akredituar nga QKEV-ja, ka qënë pak a shumë në të njëjtat nivele me atë të vitit të mëparshëm.

Në total në vitin 2015 janë organizuar 407 aktivitete të akredituara për profesionistët e shëndetësisë, ku kanë marrë pjesë 15538 profesionistë të shëndetësisë dhe janë ofruar 159,801 kredite. Nga numri i total i aktiviteteve të ofruara, një pjesë e tyre prej rreth 120 aktivitete të akredituara i takon kategorise se aktiviteteve te të përsëritura. Një aktivitet i akredituar mund të përsëritet brenda një periudhe kohore prej tre vjetësh mbas akreditimit të tij fillestar nga QKEV-ja.

QKEV-ja ka qënë e kujdesshme që një vëmendje të veçantë ti kushtojë përmirësimit të cilësisë të aktiviteteve nëpërmjet procesit të akreditimit të tyre, si dhe garantimit të standardeve të deklaruara, nëpërmjet monitorimit të organizimit të tyre. Gjatë vitit 2015, numri i aktiviteteve të cilëve i u është refuzuar apo anuluar akreditimi shkon në 28 aktivitete te refuzuara ose te anuluar, për shkelje të ndryshme të standardeve të akreditimit.

Për vlerësimin e përmbajtjes së këtyre aktiviteteve QKEV ka vazhduar bashkëpunimin me stafin akademik të Universitetit të Mjekësisë së Tiranës. Ky bashkëpunim ka qënë i mirë, por gjithsesi janë vërë re dhe mangësi kryesisht në zbatimin e afateve kohore dhe nganjehere të vlerësimeve të përcipta nga disa ekspertë. QKEV është e angazhuar në përmirësimin e këtyre raporteve dhe njëkohësisht në zgjerimin e burimeve të përzgjedhjes së këtyre ekspertëve.

Duke filluar nga viti 2013, QKEV-ja ka filluar akreditimin dhe të aktiviteteve të edukimit në distancë. Në vitin 2015 u ofruan në distancë 28 aktivitete të tilla te akredituara. Në përgjithësi, këto aktivitete në distancë janë bazuar në një platforme, për përdorimin e të cilës disa ofrues janë trajnuar me kontributin e Kooperacionit Zviceran. Kjo platformë është vetëm një hap i parë, që jep mundësinë e paraqitjes së aktiviteteve të edukimit në vazhdim në këtë format. Ka ende shumë mundësi për të rritur gamën dhe

cilësinë e paraqitjes së këtyre aktiviteteve në distancë. Qëllimi i QKEV-së do të jetë, që këto aktivitete, përveç përmbajtjes shkencore dhe bashkëkohore, të kenë dhe një format sa më të thjeshtë, për të mundësuar aksesin e një numri sa më të madh profesionistësh. Një sfidë ende për tu zgjidhur për këto aktivitete, mbetet pamundësia e pagesës online të tarifave të pjesëmarrjes. QKEV-ja është e angazhuar në respektimin e kriterëve të akreditimit për këtë kategori aktiviteteve edhe për sa i takon shmangies së rasteve të pjesëmarrjeve fiktive në to.

Në zbatim të prioriteteve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë për sistemin e edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetësisë, QKEV-ja i ka pasur ato në qëndër të vëmendjes së saj. Në këtë funksion, u rishikuan të gjitha procedurat e akreditimit të këtyre aktiviteteve, duke marrë mendimet dhe të të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces dhe u bënë ndryshimet e duhura, që u reflektuan në ligjin dhe VKM përkatëse, të aprovuara gjatë vitit 2015 (shiko më poshtë).

Gjithashtu është punuar ngushtësisht me projektin e sipër përmendur, për promovimin e aktiviteteve institucionale të edukimit në vazhdim të formatit “peer review”, të organizuara nga ofruesit e kujdesit shëndetësor parësorë në dy rrethe pilot, për stafet e tyre të mjekëve dhe infermirëve.

Duhet thënë, që në vitin 2015, numri i aktiviteteve institucionale të ofruara nga institucionet publike të kujdesit shëndetësor parësor, dytësor, apo dhe terciar, nuk ka qënë në pritshmëritë dhe në kërkesat ligjore që këto institucione kanë pasur në ofrimin e këtyre aktiviteteve për stafet e tyre profesionale. Këtu mund të përmendim që gjatë vitit 2015 nga numri i madh i qendrave shëndetësore dhe spitaleve në mbarë vendin, të vetmet, që kanë aplikuar për akreditim të aktiviteteve institucionale për vetë stafet e tyre të profesionistëve për vitin 2015, janë: Shërbimi i Neurokirurgjisë QSUT, Njësia e kontrollit të infeksionit QSUT, , SUOGJ "Koco Glozheni" , QSUT Shërbimi i Pediatriisë, Shërbimi djegje Plastikës QSUT , Spitali Kukës, , Spitali Krujë , Spitali Korçë, Spitali Universitar Shevqet Ndroqi, SUOGJ “Mbreteresha Geraldine”, Spitali Lushnjë, DSHP Kavajë, DSHP Vlorë, Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë, DSHP Tepelenë, QSH Rrogozhinë, QSH Shkozë Durrës, QSH Vërtop Berat.

Kjo situatë do të kërkojë një angazhim më të madh në të ardhmen, të kapaciteteve ekzistuese në spitalet dhe qendrat shëndetësore për ofrimin e aktiviteteve për edukimin në vazhdim të stafeve të tyre. QKEV-ja

ka pasur dhe vazhdon të ketë një qëndrim mjaft bashkëpunues për mbështetjen e këtyre ofruesve dhe akreditimin sa më lehtësues dhe pa kosto financiare për këto kategori aktivitetesh.

Për vitin 2016, në lidhje me akreditimin, objektivat e rëndësishëm të QKEV-së janë:

1. hartimi i dy udhëzuesve të procesit të akreditimit dhe një udhëzuesi të procesit të certifikimit, bazuar në ndryshimet ligjore dhe VKM-ve përkatëse, të miratuara gjatë vitit 2015, nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave.
2. mbështetja me prioritet e institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor, në mbarëvajtjen dhe zhvillimin prej tyre të aktiviteteve të akredituara, për stafet e tyre të profesionistëve.
3. bashkëpunimi me aktorë kryesorë, për hartimin e bazës juridike dhe kriterëve e standardeve të akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.

Gjatë vitit 2015 një vëmendje e veçantë i është kushtuar procesit të monitorimit të aktiviteteve të akredituara apo në proces akreditimi me synim garantimin e plotësisë të standardeve dhe kriterëve të cilësisë së edukimit në vazhdim. Në këtë proces QKEV-ja ka qenë e orientuar drejt kontrollit të ofruesve për përmirësimin e cilësisë dhe përmbushjen e standardeve të aktiviteteve të ofruara prej tyre.

Në total në vitin 2015 janë monitoruar 45 aktivitete. Nga këto, për 5 aktivitete është anuluar ose refuzuar akreditimi ose për arsye të caktuara ka patur reduktim të numrit të krediteve. Arsyeja e refuzimit të akreditimit të aktiviteteve ose anulimit të tij ka qenë moskryerja e aktivitetin në datën e caktuar pa njoftim paraprak në QKEV dhe shkelja e kriterit të konfliktit të interesit ose përdorimi i aktivitetit të edukimit në vazhdim për qëllime komerciale.

Të gjitha problematikat e konstatuara gjatë monitorimit sugjerojnë ndryshime e përmirësime si në punën e vetë QKEV-së ashtu dhe në atë të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Rrjedhimisht disa objektiva të QKEV-së për vitin në vazhdim në lidhje me monitorimin e aktiviteteve janë:

4. Monitorimi i një numri mbi 100 aktiviteteve të planifikuara dhe që do të zhvillohen gjatë vitit të ardhshëm.
5. Rritja e aftësive për të monitoruar dhe kontribuar në cilësinë e aktiviteteve të edukimit në distancë që do të organizohen nga ofrues vendas.

6. Ngritja apo përmirësimi i rrjetit të koordinatorëve me qëllim shpërndarjen e aktiviteteve të monitoruara në të gjitha rrethet kryesore të vendit.
7. Organizimi i aktiviteteve rifreskuese mbi kriteret e akreditimit dhe standardet e cilësisë, me kategoritë e ndryshme të ofruesve, me një fokus të veçantë mbi kriterin e konfliktit të interesit, teknikat pedagogjike dhe vlerësimin e nevojave të profesionistëve.
8. Mbajtja e një qëndrimi penalizues të menjëhershëm ndaj shkeljes së konfliktit të interesit ose moszhvillimit të aktivitetit pa njoftim paraprak, ndryshe nga qëndrimi penalizues i përshkallëzuar i mbajtur deri më tani.
9. Monitorimi i vlerësimit të aktivitetit nga stafi i QKEV-së me anë të formularëve të vlerësimit për pjesëmarrësit sa herë që kjo gjë është e mundur për disa nga aktivitetet e monitoruara. Përfundimet e këtij vlerësimi bëhen pjesë e rezultateve të monitorimit dhe procesit të akreditimit të aktivitetit.

Në lidhje me certifikimin e profesionistëve, puna e QKEV gjatë 2015 është përqëndruar në:

- Saktësimin e të dhënave personale dhe ato të lidhura me kreditet për të gjithë profesionistët të regjistruar në regjistër dhe që janë në marrëdhënie pune, ka kryer regjistrime të reja si dhe ka hedhur në kartelat personale të profesionistëve kreditet e marra në aktivitete të ndryshme të edukimit në vazhdim.
- Informimi i profesionistëve dhe i të gjithë aktorëve të interesuar mbi gjendjen aktuale të përmbushjes së detyrimeve që lidhen me programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë.
- Ka bërë rekomandimet e nevojshme për Bordin e Edukimit të Vazhdueshëm në lidhje me kriteret e reja që u vendosën në VKM nr.789 datë 22.09.2015 për "Përcaktimin e Kritereve, Standardeve dhe Procedurave të Programit të Certifikimit për Profesionistët e Shëndetësisë".
- Ka përpunuar dhe analizuar të dhënat nga Regjistri Kombëtar i certifikimit si dhe ka hartuar raporte për institucionet e interesuara.
- Janë hedhur në kartelat individuale të profesionistëve kreditet që u përkasin aktiviteteve të edukimit në vazhdim të paakredituara nga QKEV sipas kërkesës për njohje kreditesh që kanë dorëzuar pranë sektorit të certifikimit.

- Eshtë bërë regjistrimi i infermierëve dhe mamive të cilët e filluan ciklin në janar të vitit 2016, si dhe janë bërë ndryshimet sipas kërkesave në të dhënat personale të tyre.

Objektivat e QKEV për vitin 2016 në lidhje me certifikimin janë:

10. Përmiresimi i regjistrit të certifikimit në mënyrë që të minimizohen gabimet dhe pasaktësitë.
11. Hartimi i udhëzuesit të ri të cërtifikimit bazuar në ndryshimet ligjore të miratuara në vitin 2015

## I. **ECURIA E AKREDITIMIT TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM**

### **1. Ndryshimet e ligjore të kryera gjatë vitit 2015**

Në vitin 2015, QKEV-ja u angazhua në procesin e hartimit të propozimeve për ndryshime ligjore dhe hartimin e dispozitave ligjore ku do të bazohet veprimtaria e mëtejshme e saj.

U bënë disa propozime për sa i takon disa aspekteve të rëndësishme të procesit të akreditimit. Ndër këto mund të veçojmë propozimin e disa kritereve të ndryshuara për akreditimin e aktiviteteve në distancë, për akreditimin e aktiviteteve të organizuara nga institucionet publike të kujdesit shëndetësor për stafet e tyre të profesionistëve dhe gjithashtu për procedurat financiare të akreditimit të këtyre aktiviteteve.

E gjithë kjo punë u konkretizua me miratimin e neneve të ndryshuara për edukimin në vazhdim në ligjin e kujdesit shëndetësor dhe miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr 788 datë 22/09/2015 për “Përcaktimin e kritereve, standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”.

### **2. Kategoritë e ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim**

Gjatë vitit 2015 kanë ofruar aktivitete të edukimit në vazhdim rreth 126 ofrues të këtyre aktiviteteve, pra ka pasur nje rrije te numrit te ofruesve e krahasuar kjo me numrin prej 118 te tyre qe aplikuan gjate vitit 2014. Në këtë numër të lartë ofruesish kanë kontribuar të gjitha kategoritë e ofruesve të edukimit në vazhdim duke përfshirë ofrues publikë të këtyre aktiviteteve ashtu si edhe ofrues privatë.

QKEV-ja, në funksionin e saj si promovuese dhe koordinatore e sistemit të edukimit në vazhdim të tërësinë e tij, ka fokusuar në aktivitetin e saj dhe ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e këtyre ofruesve, përgjatë gjithë kësaj periudhe.

Këtu mund të përmendim punën e vazhdueshme për përmirësimin e standardeve të ofrimit të aktiviteteve që bëhet me çdo ofrues gjatë procesit të akreditimit, ashtu si dhe takime të vecanta që janë mbajtur me ofrues të ndryshëm, si me drejtuesit dhe stafin e SUSM, apo drejtues të kujdesit parësor në Burrel dhe në Fier, me qëllim sensibilizimin e tyre në ofrimin e aktiviteteve më të larmishme dhe me cilësore për stafet e profesionistëve të tyre.

Ndër ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim pjesa më e madhe kanë qënë ofrues të mëparshëm të këtyre aktiviteteve por ka pasur dhe ofrues të rinj që kanë ofruar për herë të parë aktivitete të tilla.

Në mënyrë më të detajuar po paraqesim më poshtë kategoritë e ofruesve sipas numrit të aktiviteteve të ofruara, krediteve dhe pjesëmarrësve në këto aktivitete:

**Tab 1. Aktivitete sipas Ofruesve për vitin 2015**

Nr.	Ofruesi	Kreditet e Aktivitetit	Numri i Aktiviteteve	Numri i Pjesëmarrësve
1	<b>Ofrues akademik private</b>			
2	Albanian University	2,976	5	260
3	UZKM	233	9	23
4	Aldent	934	7	154
5	Total	4,143	21	437
6	Akademia e Shkencave e Shqipërisë	227	1	38
7	Fakulteti i Infermierisë Tirane	255	1	52
8	Fakulteti i Mjekësisë Tirane	9,630	4	513
9	Fakulteti i Shëndetit publik Vlorë	320	1	12
10	Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan, Departamenti Infermierisë	5,040	1	275
11	<b>Total</b>	<b>15,472</b>	<b>8</b>	<b>890</b>
12	<b>Ofrues QSH / Spitale</b>			
13	SUOGJ "Koco Glozheni"	0	2	0
14	QSH nr 1 Fier	420	1	16
15	QSUT - Sherbimi i Kirurgjisë	5,777	1	419
16	QSUT - Sherbimi i pediatriës	0	1	0
17	QSUT - Sherbimi i Reumatologjisë	0	1	0
18	QSUT - Sherbimi ORL	0	1	0
19	Spital Rajonal Durres - Sherbimi i kirurgjisë, ortopedisë dhe i pediatriës	468	2	54
20	Spitali Amerikan Tirane	10,070	2	898
21	Spitali Psikiatrik Elbasan	0	2	0

22	Spitali Rajonal Vlore	403	1	82
23	Spitali Salus	1,384	12	456
24	QSUT - Sherbimi I djegjes dhe kirurgjise plastike	220	1	11
25	Spitali Kruje	512	2	125
26	Spitali rajonal Korce	0	1	0
27	QSH Rrogozhine	0	1	0
28	QSH Vertop	12	1	3
29	Spitali Kukes	0	1	0
30	QSUT	487	3	97
31	Sherbimi i Neurokirurgjise, QSUT	0	2	0
32	Klinika Diplomat	400	2	10
33	QSH nr 7 Shkozet, Durres	170	1	7
34	QSH Nr 3, Fier	0	1	0
35	Spitali Lushnje	0	1	0
36	Klinika Fithealth	592	1	76
37	Spitali European	1,008	1	172
38	QSUT, Sherbimi i Hematologjise	552	1	96
39	Spitali Rajonal Shkoder	0	1	0
40	<b>Total</b>	<b>22,475</b>	<b>48</b>	<b>2,522</b>
41	<b>Ofrues MSH (ISHP/DSHP etj)</b>			
42	Autoriteti Shendetesor Rajonal	483	1	71
43	DRSHP Fier	600	2	27
44	DSHP Gjirokaster	688	1	76
45	ISHP	3,715	17	543
46	Ministria e Shendetesise Shqiptare	654	4	36
47	QKCSA-ISH	223	4	65
48	Qendra Kombetare e Transfuzionit te Gjakut	601	1	117
49	DSHP Kavaje	0	2	0
50	DSHP Shkoder	0	1	0
51	<b>Total</b>	<b>6,964</b>	<b>33</b>	<b>935</b>
52	<b>Ofrues OJF</b>			
53	Caritas Shqiptar	280	5	60
54	Fondacioni Fryma e Dashurise	165	2	16
55	Fondacioni Shendetesor ABC	210	2	8
56	International Virtual e-Hospital Foundation	1,413	1	77
57	ISSAT	3,321	10	69
58	Qendra e trajnimit profesional mjeksor "Santa Maria"	5,317	6	245
59	Qendra Shkencore e Kerkimeve Statistikore, Informacionit dhe Teknologjise (SSRC&IT)	132	4	5
60	Shoqata Kujdesi Shendetesor Familjar	3,279	21	344
61	Seiss Foundation for Innovation	1,621	3	40
62	Madonina della grapa	0	2	0
63	Fondacioni shqiptetar kunedr semundjeve infektive dhe	0	4	0



	AIDS			
64	ACA Albanian Community Assisst	4,615	4	71
65	Qendra per Studime te Avancuara	15	3	5
66	Fondacioni "Doën Syndrome Albania"	690	1	99
67	Shoqata e Farmakoekonomise dhe Studimit te Rezultateve ne shendet e Shqiperise	3,228	5	345
68	Instituti i Sherbimeve Psikologjike per Komunitetin	66	7	11
69	Qendra Vullnetare e Emergjencave civile	3,713	4	123
70	Instituti Shqiptar i Shendetit dhe Zhvillimit Shoqeror	13,447	24	469
71	Qendra Shqiptare per Kerkim dhe Edukim Shendetesor	52	2	4
72	Qendra per Zhvillim dhe Iniciative Sociale	0	1	0
73	Projekti "Shendet per te gjithe"	1,088	5	142
74	Qendra Kerkimore Nderdisiplinore Litura	8	1	2
75	Qendra Komunitare Psiko-terapeutike	0	1	0
76	Emergency Response Albania	54	1	2
77	Fondacioni Spitalor i Nenes dhe Femijes	0	2	0
78	Shoqata e Talasemise dhe hemoglobinopative te tjera	0	1	0
79	Together for life	0	3	0
80	Shoqata Shqiptare per Kerkim dhe Edukim Shendetesor	0	1	0
81	<b>Total</b>	<b>42,714</b>	<b>125</b>	<b>2,137</b>
82	<b>Ofrues Shoqata Profesionistesh</b>			
83	AGEA	448	1	26
84	Asocimi Nacional i Dentisteve Shqiptare	1,080	5	148
85	Shoqata Dentare Shqiptare	13,512	9	1,539
86	Shoqata e Anestezisteve dhe Reanimatoreve te Shqiperise	4,472	1	170
87	Shoqata e Endoskopise Gjinekologjike	0	1	0
88	Shoqata e Infeksionisteve	1,188	1	175
89	Shoqata e Ortodonteve Shqiptare	1,454	2	222
90	Shoqata Shqiptare e Pneumologeve	0	6	0
91	Shoqata Kombetare e Shendetit Publik	8,954	50	1,481
92	Shoqata Pediatrike Shqiptare	1,050	4	283
93	Shoqata Shqiptare e Alergologjise dhe Imunologjise Klinike	1,422	1	119
94	Shoqata Shqiptare e Hipertensionit Arterial	1,371	11	441
95	Shoqata Shqiptare e Kardiologjise	663	2	135
96	Shoqata Shqiptare e Neurologjise	0	1	0
97	Shoqata Shqiptare e Obstetrike Gjinekologjise	2,920	1	169
98	Shoqata Shqiptare Gastro-Entero-Hepatologjise	792	1	131
99	Shoqata e Diabetit	1,007	8	233
100	Shoqata Shqiptare e Psikiatrize	0	1	0
100	Shoqata shqiptare e fizioterapisteve	0	1	0

1				
10				
2	Shoqata e ortopedëve dhe traumatologëve shqiptarë	3,906	1	269
10				
3	Shoqata "Per nje Shqiperi te shendeteshme"	2,382	3	393
10				
4	Kolegji Shqiptar i Mjekesise	1,333	1	102
10				
5	Shoqata Shqiptare e Urgjencave Mjekesore	664	2	120
10				
6	MAYA	3,716	9	345
10				
7	Shoqata shqiptare e studimit dhe aplikimit te ultratingulli ne mjeksi dhe biologji	2,078	6	28
10				
8	Shoqata medico- onkologjike shqiptare	615	2	60
10				
9	Shoqata Shqiptare e Traumes	99	1	15
11				
0	Shoqata Shqiptare e Aplikimit te Ulpratingullit ne Mjekesi e Biologji	0	1	0
11				
1	Shoqata Shqiptare e Riprodhimit Human dhe Andrologjise	0	1	0
11				
2	Alzheimer Albania	0	1	0
11				
3	Albanian society ultrasound in medicine and biology& Klinika Erton	0	1	0
11				
4	<b>Total</b>	<b>55,126</b>	<b>136</b>	<b>6,604</b>
11				
5	<b>Ofrues Urdhera Profesionistesh</b>			
11				
6	UFSH	11,381	18	1,849
11				
7	UISH	0	2	0
11				
8	<b>Total</b>	<b>11,381</b>	<b>20</b>	<b>1,849</b>
11				
9	<b>. I Pa percaktuar</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>
12				
0	Mediterranean society of pacing and electrophysiology	0	1	0
12				
1	Total	0	2	0
12				
2	NetRDA	188	1	7
12				
	Doktori im.com	9	1	1

3				
12				
4	Ministria e Mireqenies Sociale	176	2	44
12				
5	Akademia e Studimeve te Aplikuara REALD	0	1	0
12				
6	Shoqata e Distributoreve te materialeve dhe paisjeve dentare	672	2	16
12				
7	Farmaci Luiza	0	1	0
12				
8	Akademia Shqiptare e Mjekeve te Familjes	481	2	96
12				
9	certipass digital skills	0	2	0
13				
0	Kryqi i Kuq Shqiptar	0	1	0
13				
1	SECID	0	1	0
13				
2	Total	1,526	14	164
13				
3	<b>TOTAL</b>	<b>159,801</b>	<b>407</b>	<b>15,538</b>

Dukshëm rolin kryesor në ofrimin e këtyre aktiviteteve e mbajnë shoqatat profesionale të ndjekura nga OJF të ndryshme dhe qendrat shëndetësore apo spitalet. Për sa i takon disa prej institucioneve që kanë dalluar për numrin e madh dhe temat e shumta që kanë trajtuar në to, mund të përmendim : disa shërbime të QSUT-së, si psh. shërbimi i neurokirurgjisë, shërbimi i kontrollit të infeksioneve spitalore; Shoqatën Kombëtare të Shëndetit Publik Institutin e Shëndetit Publik; Urdhrin e Farmacistëve; Universitetin “Zoja e Këshillit të Mirë”; Fondacionin “ABC”, etj.

Mbetet ende për tu bërë, në shtimin dhe përmirësimin e standardeve të aktiviteteve institucionale të ofruara nga institucionet e kujdesit shëndetësor për vetë stafet e profesionistëve, të cilat gjatë këtij viti ishin më të pakta dhe shumë prej atyre, që deklaruan se do të organizonin aktivitete, në fakt u tërhoqën nga ky proces.

### **3. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas formatit të tyre**

Dhe gjatë vitit 2015 është ruajtur tendenca e organizimit të një numri më të madh të aktiviteteve të formatit të trajnimeve, në krahasim me formatet e tjera. Gjatë këtij viti janë zhvilluar një numër prej 149 trajnimesh ku kanë marrë pjesë kategori të ndryshme të profesionistëve. Ndërkohë, në paraqitje të detajuar numri i aktiviteteve të ofruara sipas formatit të tyre për vitin 2015 jepet si në grafikun dhe tabelën e mëposhteme:

**Tabela 2 . Numri i aktiviteteve sipas formatit për vitin 2015**

Lloji Aktivitetit	Kreditet e Aktivitetit	Numri i Aktiviteteve	Numri i Pjesmarresve
Konferencë	80,103	87	7,344
Uorkshop	2,758	18	552
Seminar	2,420	16	453
Leksion	22,506	52	3,867
Trajnim	25,867	149	1,779
Trajnim në vendin e punës	626	11	27
Trajnim për Trajnerë	14,150	34	519
Në distancë	9,437	28	523
Tjetër	1,934	11	474
<b>Total</b>	<b>159,801</b>	<b>407</b>	<b>15,538</b>

**Graf 2. Numri i aktiviteteve sipas formatit për vitin 2015**

Siç vihet re, numri i aktiviteteve të formatit trajnim vazhdon të mbetet i lartë i ndjekur nga ai i aktiviteteve të formatit konferencë. Një rritje fort të dallueshme kanë pasur dhe aktivitetet e ofruara në distancë, si një tendencë e re që ofron akses te shpejtë dhe avantazhe kohore e logjistike të shumta për kategori të shumta të profesionistëve të shëndetësisë. Duhet theksuar se duhet punuar ende shumë për të rritur standardin e hartimit dhe ofrimit këtyre aktiviteteve, gjë që kërkon një profesionalizëm dhe kapacitete të specializuara, për të bërë të mundur, që këto aktivitet të këtij formati, të bëhen një burim i rëndësishëm për përditësimin e njohurive të profesionistëve të shëndetësisë.

#### **4. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas target grupit**

Për sa i takon kategorive të profesionistëve të shëndetësisë që kanë marrë pjesë në aktivitet të akredituara, shpërndarje e numrit të aktiviteteve të ofruara sipas target grupeve, paraqitet si në tabelën mëposhtë:

**Tab 3. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas target grupit viti 2015**

Target Group	Kreditet e Aktivitetit	Numri i Aktiviteteve	Numri i Pjesëmarrësve
Mjeke specialiste	20,725	49	1,876
Mjekë të përgjithshëm	14,412	36	640
Stomatologë	23,491	34	2,524
Farmacistë	11,193	18	1,827
Infermierë	622	14	56
Mjekë specialist dhe infermierë	5,822	35	883
Mjekë të përgjithshëm dhe infermierë	2,751	25	162
Mjekë të përgjithshëm dhe specialistë	27,121	58	3,430
Menaxherë	24	3	1
Multidisiplinar	53,632	131	4,137
Fizioterapistë	0	2	0
<b>Total</b>	<b>159,801</b>	<b>407</b>	<b>15,538</b>

**Graf 3. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas target grupit për vitin 2015**

Vihet re një numër i madh aktivitetesh që kanë synuar të jenë për një target të përgjithshëm pjesëmarrësish duke synuar kështu një pjesëmarrje sa më të madhe dhe tema me informacion më të përgjithshëm. Nga ana tjetër vazhdon të ruhet tendenca për një numër më të madh aktivitetesh për mjekët specialistë që arrijnë të gjejnë më lehtë mbështetje financiare për organizimin e aktiviteteve të tyre. Ngelet ende fare i vogël numri i aktiviteteve të organizuara posaçërisht për kategorinë e infermiereve, gjë e cila duhet të merrte në konsideratë dhe të synohet për tu ndryshuar duke parë përfshirjen e infermiereve dhe mamive në programin e certifikimit duke filluar nga janari i vitit 2016.

Një rritje të ndjeshme kanë patur dhe aktivitetet për farmacistë dhe dentistë, kjo fal një punë më të madhe të bërë në ofrimin e këtyre aktiviteteve kryesisht nga urdhrat profesionalë dhe shoqatat respektive për këto kategori profesionistësh. Gjithsesi, duhet përmendur që për këto dy kategori profesionistësh mundësisht për të asistuar në trajnime specifike të targetuara veçanërisht për ta, kanë qënë më të pakta. Dhe ofruesit e aktiviteteve për këta profesionistë janë më të paktë, sidomos për ofrues që ofrojnë aktivitete në rajone apo rrethe në periferi të territorit të vendit.

##### **5. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas burimit financiar**

**Tab 4 . Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas burimit financiar për vitin 2015**

<b>Burimi Financiar</b>	<b>Kreditet e Aktivitetit</b>	<b>Numri i Aktiviteteve</b>	<b>Numri i Pjesëmarrësve</b>
Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë	375	1	15
Institucion tjetër shtetëror	0	1	0
Sponsor tregtar	12,521	37	2,117
Kuotat e regjistrimit/ndjekjes së aktivitetit	47,055	117	4,151
Vete organizata	46,324	171	4,322
Vetë organizata dhe kuotat e regjistrimit	30,406	50	3,160
Sponsor tregtar dhe kuotat e regjistrimit	8,453	10	769
Tjetër	4,593	4	179
.I Pa Percaktuar..	0	1	0
Fonde	8,329	13	470
Fonde dhe kuotat e regjistrimit	1,745	2	355
<b>Total</b>	<b>159,801</b>	<b>407</b>	<b>15,538</b>

Ndërkohë, për vitin 2015-të, detajet e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në funksion të burimit të financimit tregojnë që dy burimet kryesore të financimit kanë qënë kuotat e pjesëmarrjes dhe donatorët

Siç vihet re nga grafikët dhe nga tabela e mëposhtëme, tre kategoritë kryesore të financimit, përgjatë vitit 2015, kanë qënë: donacionet; kuotat e regjistrimi; dhe një kombinim i koutave me financime të vetë organizatës ofruese. Vihet re një numër i madh aktiviteteve me sponsor tregëtar të deklaruar. Tendenca e pagesës së kuotave të pjesëmarrjes vazhdon të jetë një konstante e mënyrave për financim të aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

**Graf 4. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas burimit financiar për vitin 2015**

## **6. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas shpërndarjes gjeografike.**

Për sa i takon shpërndarjes gjeografike të organizimit të këtyre aktiviteteve mund të paraqesim tabelën 5 më poshtë:

Qyteti Aktivitetit	Kreditet e Aktivitetit	Nr Aktivitetev	Pjesemarres
Berat*	619	4	95
Vërtop	12	1	3
Çorovodë*	0	1	0
Bulqizë*	258	2	9
Arras	0	1	0
Peshkopi*	931	4	83
Burrel*	718	2	38
Durrës*	2,646	14	397
Fushë-Krujë*	241	2	78
Krujë*	512	2	125
Elbasan*	9,996	23	1,211
Shushicë	165	1	16
Gramsh*	4,615	1	71
Librazhd*	0	1	0
Fier*	3,079	15	310
Kurjan	0	1	0
Lushnjë*	2,145	6	132
Ballsh*	855	1	26
Gjirokastër*	2,318	5	180
Përmet*	773	2	39
Kurvelesh	0	1	0
Tepelenë*	627	2	32
Bilisht*	1,403	1	50
Ersekë*	0	1	0
Korçë*	4,760	25	658
Pogradec*	1,725	4	148
Krumë*	163	2	6
Kukës*	309	2	101
Tropojë	367	1	11
Laç*	704	1	24
Lezhë*	893	2	44
Fan	4	1	1

Rrëshen*	738	2	46
Pukë*	68	2	2
Shkodër*	2,740	12	200
Golem	0	1	0
Kavajë*	0	1	0
Rrogozhinë*	0	1	0
Pezë	1,475	3	17
Tirana*	99,153	203	10,052
Vaqarr	196	1	47
Delvinë*	339	1	10
Sarandë*	474	2	16
Vlorë*	2,936	14	440
<b>Total</b>	<b>179,355</b>	<b>407</b>	<b>16,814</b>

Siç vihet re në këtë tabelë kemi një shpërndarje shumë jo proporcionale midis Tiranës dhe rretheve të vendit. Më shumë se gjysma e aktiviteteve të zhvihuara gjatë vitit 2015 kanë ndodhur në Tiranë. Nderkohe që, në Durrës janë zhvilluar 14 aktivitete të akredituara, në Fier 15 dhe në Korçë 25 të tilla.

## II. MONITORIMI DHE SIGURIMI I CILËSISË SË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

Në vitin 2015 një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe procesit të monitorimit të aktiviteteve të akredituara apo në proces akreditimi me synim garantimin e plotësisht të standardeve dhe kritereve të cilësisë së edukimit në vazhdim.

Në këtë proces QKEV-ja ka qenë e orientuar drejt kontrollit të ofruesve për përmirësimin e cilësisë dhe përmbushjen e standardeve të aktiviteteve të ofruara prej tyre. Në rastet e shkeljeve të këtyre standardeve QKEV-ja ka marrë masat përkatëse sipas parashikimeve në Dokumentin Rregullator të Akreditimit e më tej, pas hyrjes në fuqi të saj VKM-së nr.788 dt 22.09.2015.

Në total gjatë vitit 2015 janë monitoruar 45 aktivitete. Nga këto, për 5 aktivitete është anuluar ose refuzuar akreditimi ose për arsye të caktuara ka patur reduktim të numrit të krediteve. Arsyeja e refuzimit të akreditimit të aktiviteteve ose anulimit të tij ka qenë moskryerja e aktivitetit në datën e caktuar pa njoftim paraprak në QKEV dhe shkelja e kriterit të konfliktit të interesit ose përdorimi i aktivitetit të edukimit në vazhdim për qëllime komerciale.



Numri i reduktuar në krahasim me një vit më parë i aktiviteteve të monitoruara lidhet me dy faktorë kryesor, mobilizimin e punës së stafit të sektorit të monitorimit në mbylljen e ciklit 5 vjeçar në tre-mujorin e parë të vitit 2015 duke mos u kryer fare monitorime gjatë këtij 3-mujori dhe mungesa e 2 nga 3 pjestarët e sektorit të monitorimit gjatë gjysmës së dytë të vitit 2015.

Një faktor tjetër që ka ndikuar në numrin e monitorimeve dhe lokalizimin e tyre në Tiranë është mosangazhimi i koordinatorëve lokalë në këtë proces. Kjo është një hallkë që duhet ngritur apo përmirësuar gjatë vitit 2016 me qëllim shpërndarjen e aktiviteteve të monitoruara në të gjitha rrethet kryesore të vendit.

Falë një ekperience disavjeçare bashkëpunimi mes ofruesve të aktiviteteve dhe QKEV-së, shumë aspekte të planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve nga ana e organizatorëve tashmë janë më të qarta, gjithashtu sugjerimet specifike të vazhdueshme që i janë dërguar organizatoreve përmes raporteve të monitorimit kanë rritur saktësinë e zhvillimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim sipas standardave të kërkuara nga legjislacioni, sidomos përsa i përket konfliktit të interesit dhe përdorimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim në funksion të objektivit të edukimit dhe jo marketimit të produkteve.

Vendosja e standardeve mbetet ende një sfidë për aktivitetet e edukimit në distancë.

Problemet më të hasura gjatë procesit të monitorimit janë:

- *Ndryshimet në program ose vendndodhje.* Ndryshimet në program ose vendndodhje të aktivitetit pa lajmëruar QKEV-në është një fenomen i përhapur te ofruesit, i cili shpesh shpjegohet me neglizhimin ndaj rregullave dhe kërkesave të QKEV-së.
- *Monitorimi i pjesëmarrësve.* Për aktivitete të llojit të konferencës mbetet ende sfidë si për organizatorin ashtu dhe për QKEV-në monitorimi i duhur i numrit të pjesëmarrësve.
- *Konflikti i interesit.* Vihet re një përmirësim nga ana e ofruesve në zbatimin e kriterit të konfliktit të interesit nga fillimi deri më sot, por vazhdon të mbetet problemet për disa ofrues, kryesisht ofrues të aktiviteteve, të cilët mbështeten financiarisht për herë të parë nga sponsor tregëtar.
- *Teknikat pedagogjike.* Kriteri i teknikave pedagogjike mbetet një kriter i papërbushur në një masë të konsiderueshme aktiviteteve. Megjithë angazhimin serioz të organizatorëve, aspektet e mësimdhënies janë kryesisht tradicionale dhe jo inovative. Forma më e zgjedhur është leksion teorik duke e bërë jo interesant për pjesëmarrësit

dhe në disa raste pjesëmarrjen vetëm formale. Në lidhje me konferencat, edhe pse prezantimet janë cilësore mungon impenjimi për t'i përfshirë pjesëmarrësit në pyetje e diskutime si nga vetë lektorët ashtu dhe nga moderatorët. Në konferenca është vënë re tendenca për të mos përkthyer prezantimet e lektorëve të huaj në gjuhën shqipe, ose dhe prezantimet e lektorëve shqiptarë në gjuhë të huaj me argumentimin se pjesëmarrësit nuk kanë nevojë për përkthim.

Aktivitetet e edukimit në distancë, edhe për shkak seorganizimi i tyre është një risi për Shqipërinë, paraqesin deri më tani mangësi kryesisht në konceptimin pedagogjik (përfshirë përdorimin e mjeteve vizuale, hapësirat ndërvepruese) dhe në monitorimin e punës së pjesëmarrësve në këto aktivitete përtej testit të njohurive para dhe pas aktivitetit. Mungon dukshëm ndërveprimi lektor pjesëmarrës duke zbehur bashkëbisedimin dhe thellimin në kërkesa sqaruese përsa i përket temës së trajtuar në aktivitet.

- *Vlerësimi i aktivitetit.* Është vënë re nga monitorimi se pjesa më e madhe e ofruesve nuk i japin rëndësinë që i takon procesit të vlerësimit të aktivitetit. Meqënëse kjo kërkesë nuk është më fleksibël, por është bërë e detyrueshme nga VKM e miratuar në shtator besojmë se ky ndryshim do të ndikojë që ky proces të kryhet rregullisht.

Të gjitha problematikat e konstatuara sugjerojnë ndryshime e përmirësime si në punën e vetë QKEV-së ashtu dhe në atë të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Rrjedhimisht disa objektiva të punës së QKEV-së për vitin në vazhdim janë:

- Monitorimi i një numri mbi 100 aktiviteteve të planifikuara dhe që do të zhvillohen gjatë vitit të ardhshëm.
- Rritja e aftësive për të monitoruar dhe kontribuar në cilësinë e aktiviteteve të edukimit në distancë që do të organizohen nga ofrues vendas.
- Ngritja apo përmirësimi i rrjetit të koordinatorëve me qëllim shpërndarjen e aktiviteteve të monitoruara në të gjitha rrethet kryesore të vendit.
- Organizimi i aktiviteteve rifreskuese mbi kriteret e akreditimit dhe standardet e cilësisë, me kategoritë e ndryshme të ofruesve, me një fokus të veçantë mbi kriterin e konfliktit të interesit, teknikat pedagogjike dhe vlerësimin e nevojave të profesionistëve.

- Mbajtja e një qëndrimi penalizues të menjëhershëm ndaj shkeljes së konfliktit të interesit ose moszhvillimit të aktivitetit pa njoftim paraprak, ndryshe nga qëndrimi penalizues i përshkallëzuar i mbajtur deri më tani.
- Monitorimi i vlerësimit të aktivitetit nga stafi i QKEV-së me anë të formularëve të vlerësimit për pjesëmarrësit sa herë që kjo gjë është e mundur për disa nga aktivitetet e monitoruara. Përfundimet e këtij vlerësimi bëhen pjesë e rezultateve të monitorimit dhe procesit të akreditimit të aktivitetit.

### III. ECURIA E CERTIFIKIMIT TË PROFESIONISTËVE TË SHËNDETËSISË

#### 1. Regjistrimi profesionistëve në programin e certifikimit

Regjistrimi i profesionistëve në programin e certifikimit është bërë mbi bazën e listave të marra nga Urdhrat e profesionistëve, lista të personelit të institucioneve shëndetësore publike apo private dhe në disa raste dhe nga listat e ofruesve të aktiviteteve. Regjistrimi i bërë mbi bazën e këtyre listave paraqet parregullsi gjë e cila reflektohet në regjistrin e profesionistëve. Në mjaft raste profesionistët nuk i kanë të dhënat personale të sakta, kanë dy kartela, mungon informacion që lidhet me datën e licencimit për herë të parë si dhe jo të gjithë profesionistët e licencuar janë të regjistruar. Gjatë viteve në vazhdim regjistrimi i profesionistëve në regjistrin e certifikimit është bërë nëpërmjet formularit të regjistrimit (i disponueshëm në faqen e internetit të QKEV) i nisur me postë elektronike, me postë të thjeshtë apo dhe me paraqitjen e tyre pranë institucionit. Megjithatë përpjekjet e bëra për përmirësimin e të dhënave të regjistrimit të certifikimit me fillimin e ciklit të ri, përsëri vërehen pasaktësi për pasojë dhe raportet e nxjerra nuk pasqyrojnë gjendjen reale.

Numri i profesionistëve të regjistruar në programin e certifikimit është rritur nga cikli i parë në të dytin (11,516 të regjistruar në fund të vitit 2014 arriti në 11,620 në fund të vitit 2015).

Njohja dhe regjistrimi i krediteve, kryhet nga QKEV-ja nëpërmjet regjistrimit në dosjen individuale elektronike të profesionistit të krediteve të përfituara prej tij në aktivitetet e edukimit në vazhdim. Procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve ndryshojnë bazuar në llojin e aktivitetit të edukimit në vazhdim nga i cili këto kredite janë përfituar.

Nga analiza e bërë në përfundim të vitit të parë të ciklit të dytë 2015 vihet re se një numër i konsiderueshëm profesionistësh (rreth 65%) e përfunduan me sukses vitin e parë të ciklit. Në vend të

parë qëndrojnë farmacistët të cilët kanë përmbushur detyrimin në masën 74%, në vend të dytë janë stomatologët me 66% dhe në fund renditen mjekët me 60%.

- Gjatë 2015 numri i profesionistëve është **11,620**, nga të cilët 6,447 mjekë, 2,663 stomatologë, 2,510 farmacistë.

Profesioni	Numri i Profesionisteve		
	AKTIV	JO-AKTIV	TOTAL
Mjek	5,846	601	6,447
Stomatolog	2,569	94	2,663
Farmacist	2,458	52	2,510
<b>Total</b>	<b>10,873</b>	<b>747</b>	<b>11,620</b>

## 2. Numri total i krediteve dhe numri mesatar i krediteve për profesionist


- Numri mesatar i krediteve për profesionist për vitin e parë të ciklit të dytë është 23 kredite për mjekë, 17 kredite për stomatologë, 14 kredite për farmacistë.
- Në nivel kombëtar të gjithë profesionistët e kanë tejkaluar detyrimin minimal të detyrueshme 10 dhe 5 kredite në vit.

Profesioni	Numri i Profesionistëve			Kreditet e Marra			Kreditet Mesatare Aktiv
	AKTIV	JO-AKTIV	TOTAL	AKTIV	JO-AKTIV	TOTAL	
Mjek	5,846	601	6,447	137,062	3,946	141,008	23
Stomatolog	2,569	94	2,663	44,892	1,210	46,102	17
Farmacist	2,458	52	2,510	34,417	460	34,877	14
<b>Total</b>	<b>10,873</b>	<b>747</b>	<b>11,620</b>	<b>216,371</b>	<b>5,616</b>	<b>221,987</b>	

- Mbështetur në të dhënat e përpunuara në regjistrin kombëtar të certifikimit të QKEV-së, numri i profesionistëve aktivë<sup>1</sup> që kanë përmbushur kërkesën e detyrimit minimal të programit të certifikimit për vitin e parë arrin në shifrën 7,045 profesionitë, nga të cilët 3,524 mjekë, 1,702

stomatologë dhe 1,819 farmacistë. Në tabelën më poshtë jepet dhe përqindja e profesionistëve që kanë përbushur detyrimin e programit të certifikimit sipas kategorive.

Profesionistët Aktiv	Numri mbi Detyrimin Minimal	Nën Detyrimin Minimal		TOTAL	% Mbi Detyrimin Minimal
		Me Kredite	Pa Kredite		
Mjek	3,524	598	1,724	5,846	60%
Stomatolog	1,702	11	856	2,569	66%
Farmacist	1,819	33	606	2,458	74%
<b>Total</b>	<b>7,045</b>	<b>642</b>	<b>3,186</b>	<b>10,873</b>	<b>65%</b>



### 3. Përbushja e detyrimit minimal vjetor sipas profesionit

- Numri i profesionistëve të cilët nuk kanë përbushur kërkesat e programit të certifikimit (mjekë që kanë më pak se 10 kredite dhe farmacistë e stomatologë që kanë më pak se 5 kredite) përlllogaritet në shifrën 3,828 profesionistë. Këtu përfshihen 2,322 mjekë, 867 stomatologë dhe 639 farmacistë.

Profesioni	Ndën minimalen e detyrshme		Minimal i detyrshëm - maksimum i rekomanduar		Mbi maksimumin e rekomanduar		TOTAL
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	
Mjek	<b>2,322</b>	40%	<b>1,777</b>	30%	<b>1,747</b>	30%	<b>5,846</b>
Stomatolog	<b>867</b>	34%	<b>400</b>	16%	<b>1,302</b>	51%	<b>2,569</b>

Farmacist	<b>639</b>	26%	<b>842</b>	34%	<b>977</b>	40%	<b>2,458</b>
<b>Total</b>	<b>3,828</b>	35%	<b>3,019</b>	28%	<b>4,026</b>	37%	<b>10,873</b>

#### 4. Kreditet sipas profesioneve

##### 4.1 Mjekët

###### a. Kreditet sipas specialiteteve

Mjekët zënë numrin më të madh të profesionistëve në regjistrin e certifikimit. Brenda këtij grupi specialiteti, “mjek i përgjithshëm” zë përqindjen më të madhe (rreth 44% të numrit të mjekëve) prandaj dhe shuma e krediteve është më e lartë në krahasim me atë të specialiteteve të veçanta. Mjekët e përgjithshëm e kanë kryer detyrimin në masën 57%. Nga të dhënat e përpunuara nga regjistri i certifikimit, brenda specialiteteve specialiteti alergolog e ka kryer detyrimin në masën 92% ndërsa specialitetet endokrinolog zë vendin e dytë më detyrim të kryer në masën 91%.

Specialiteti me % më të ulët të detyrimit të kryer është mjek higjenist me 28% të detyrimit të kryer. Mjekë me detyrim të pa kryer ka nga cdo specialitet. Një situatë më e hollësishme sipas specialiteteve paraqitet në tabelën më poshtë.

Mjeket	Numri sipas Statusit te Kreditimit			TOTAL	%	Përqindja sipas Statusit te Kreditimit		
	Nen Minimum <10	Mbi Minimum (10-30)	Mbi Maksimum >30			Nen Minimum <10	Mbi Minimum (10-30)	Mbi Maksimum >30
Alergolog	3	19	14	36	0.6%	8%	53%	39%
Anestezist	30	23	108	161	2.8%	19%	14%	67%
Biokimist	30	38	29	97	1.7%	31%	39%	30%
Dermatolog	21	24	22	67	1.1%	31%	36%	33%
Endokrinolog	6	18	44	68	1.2%	9%	26%	65%
Epidemiolog	31	9	10	50	0.9%	62%	18%	20%
Gastrohepatolog	19	20	23	62	1.1%	31%	32%	37%
Hematolog	14	11	16	41	0.7%	34%	27%	39%
Higjenist	31	9	3	43	0.7%	72%	21%	7%
I përgjithshëm	1,115	824	632	2,571	44.0 %	43%	32%	25%
Imazherist	43	38	48	129	2.2%	33%	29%	37%

Infeksionist	23	35	34	92	1.6%	25%	38%	37%
Kardiolog	36	59	74	169	2.9%	21%	35%	44%
Kirurg	89	86	131	306	5.2%	29%	28%	43%
Mikrobiolog	29	23	26	78	1.3%	37%	29%	33%
Nefrolog / Urolog	26	30	25	81	1.4%	32%	37%	31%
Neonat Reanimator	22	7	16	45	0.8%	49%	16%	36%
Neurolog	28	16	34	78	1.3%	36%	21%	44%
ObsteterGjinekolog	76	105	106	287	4.9%	26%	37%	37%
Okulist	29	26	29	84	1.4%	35%	31%	35%
Onkolog	12	16	12	40	0.7%	30%	40%	30%
ORL	28	21	32	81	1.4%	35%	26%	40%
Ortoped	15	21	29	65	1.1%	23%	32%	45%
Pediater	192	93	83	368	6.3%	52%	25%	23%
Pneumolog	39	26	22	87	1.5%	45%	30%	25%
Psikiater	11	10	6	27	0.5%	41%	37%	22%
Reumatolog	21	24	20	65	1.1%	32%	37%	31%
Shendetit Publik	14	13	17	44	0.8%	32%	30%	39%
Tjeter	277	123	90	490	8.4%	57%	25%	18%
Urgjence	12	10	12	34	0.6%	35%	29%	35%
<b>Total</b>	<b>2,322</b>	<b>1,777</b>	<b>1,747</b>	<b>5,846</b>	<b>100%</b>	<b>40%</b>	<b>30%</b>	<b>30%</b>

#### b. Kreditet sipas tipit të institucionit

Sipas të dhënave vihet re që profesionistët e punësuar në sektorin publik e kanë kryer detyrimin në masën 63% ndërsa ata të sektorit privat në masën 61%. Brenda sektorit publik interesin më të lartë për përmbushjen e kërkesave të programit të certifikimit e kanë patur ata profesionistë që punojnë në nivelin terciar të shërbimeve shëndetësore që gati 80% e kanë kryer minimalen vjetore (Spitalet Universitare në Tiranë). Një situatë më e hollësishme paraqitet në tabelën më poshtë ku jepen të dhëna për mjekët aktivë sipas tipit të institucionit ku janë punësuar.

Mjeket	Numri sipas Minimumit dhe Maksimumit të krediteve të marra			TOTAL	%	Përqindja sipas Statusit		
	Nen minimal	Mbi minimal	Mbi Maksimal			Nen minimal	Mbi minimal	Mbi Maksimal
	<10	10-30)	>30			10	10-30)	>30
<b>Sektori Publik - Total</b>	<b>1,770</b>	<b>1,506</b>	<b>1,544</b>	<b>4,820</b>	<b>82%</b>	<b>37%</b>	<b>31%</b>	<b>32%</b>

Paresor	1,129	904	740	2,773	58%	41%	33%	27%
Spitalor	344	283	365	992	21%	35%	29%	37%
Terciar	158	252	369	779	16%	20%	32%	47%
Administratë	111	57	65	233	5%	48%	24%	28%
Papecaktuar & Tjeter	28	10	5	43	1%	65%	23%	12%
<b>Sektori Privat - Total</b>	<b>237</b>	<b>204</b>	<b>160</b>	<b>601</b>	<b>10%</b>	<b>39%</b>	<b>34%</b>	<b>27%</b>
Spitalor/Paresor	90	114	107	311	52%	29%	37%	34%
Klinika/Farmacit / Tjeter	147	90	53	290	48%	51%	31%	18%
<b>Papecaktuar &amp; Tjeter</b>	<b>315</b>	<b>67</b>	<b>43</b>	<b>425</b>	<b>7%</b>	<b>74%</b>	<b>16%</b>	<b>10%</b>
<b>Totali - 2015</b>	<b>2,322</b>	<b>1,777</b>	<b>1,747</b>	<b>5,846</b>	<b>100%</b>	<b>40%</b>	<b>30%</b>	<b>30%</b>

Shënim : Administratë këtu nënkupton ata mjekë që punojnë në administratë por që janë të licencuar.

#### c. Kreditet sipas fokusit të aktiviteve

Bazuar në VKM e certifikimit numri i krediteve të edukimit në vazhdim që një profesionist i përfshirë në programin e certifikimit duhet të ketë është këto raporte : të paktën 50% e krediteve të përfituara nga aktiviteve të lidhura me specialitetin, 20% nga aktiviteve të vetëraportuara pjesa tjetër e krediteve është e lirë të zgjidhet nga profesionisti sipas nevojave individuale. Nga analiza e bërë vërehet se aktualisht 82% e krediteve të marra nga mjekët janë nga aktiviteve të specialitetit, 18% nga aktiviteve të që nuk janë të specialitetit.

Shpërndarja e krediteve të profesionistëve sipas fokusit të aktivitetit			
Profesioni	Fokusi i Aktivitetit	Kreditet	%
Mjek	Jo-Specialitet	24,498	18%
	Specialitet	112,564	82%
<b>Totali - 2015</b>		<b>137,062</b>	<b>100%</b>

#### d. Kreditet sipas tipit të aktivitetit



Pjesa më e madhe krediteve janë marrë nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara nga Qendra Kombëtare Edukimit në Vazhdim. Një numër të konsiderueshëm zënë dhe aktivitetet individuale. Në tabelën më poshtë jepet një situatë e hollësishme e shpërndarjes së krediteve sipas tipit të aktivitetit.

Shpërndarja e krediteve të profesionistëve sipas tipit të aktivitetit			
Profesioni	Tipi i Aktivitetit	Kreditet	%
Mjek	Individuale	15,767	12%
	Të paraakredituara QKEV	121,062	88%
<b>Totali - 2015</b>		<b>137,062</b>	<b>100%</b>

Në aktivitetet individuale përfshihen të gjitha aktivitetet e edukimit në vazhdim të pa akredituara paraprakisht si: botimi librave, abstrakteve dhe i artikujve në revista profesionale të vendit dhe të huaja, vizita studimore të strukturuar si dhe pjesëmarrje në edukim të vazhduar jashtë vendit. Në aktivitete të paraakredituara përfshihen programe universitare të akredituara nga institucione akademike brenda dhe jashtë vendit si: master, doktorature, dhe përgatitja e kurrikulave universitare.

**e. Kreditet sipas llojit të aktivitetit.**

Nga analiza e bërë për kreditet e marra sipas llojit të aktivitetit vërehet se përqindja më e lartë e krediteve është marrë nga aktivitete trajnuese dhe nga konferencat. Një situatë më e qartë jepet në tabelën më poshtë.

Shpërndarja e krediteve sipas Llojit të Aktivitetit			
Profesioni	Lloji i Aktivitetit	Kreditet	%
Mjekë	Artikull	1,548	1.1%
	Konferencë	58,162	42.4%
	Leksion	10,709	7.8%
	Libër	904	0.7%

	On-line	3,727	2.7%
	Poster/Raport	280	0.2%
	Seminar	2,437	1.8%
	Tjetër	16,754	12.2%
	Trajnim	20,794	15.2%
	Trajnim në vendin e punës	5,471	4.0%
	Trajnim për Trajnerë	14,009	10.2%
	Uorkshop	2,267	1.7%
<b>Totali - 2015</b>		<b>137,062</b>	<b>100%</b>

Vihet re që trajnimet në vendin e punës zënë një % shumë të ulët rreth 4%. Në të ardhmen këto aktivitete duhet të zënë një vend të konsiderueshëm sepse kanë kosto relativisht më të ulët dhe janë të fokusuara në nevojat reale të profesionistëve dhe shërbimeve shëndetësore.

f. **Kreditet sipas ofruesit të aktivitetit.**

Vihet re se për kategorinë e mjekëve pjesa më e madhe e krediteve janë grumbulluar nga aktivitete të organizuara nga Shoqatat e Profesionistëve dhe nga institucione shëndetësore.

Profesio ni	Kategoria e Ofruesit	Kreditet	%
<b>Mjek</b>	Pa-Përcaktuar	15,755	11.5%
	Institucione Akademike Private	506	0.4%
	Institucione Akademike Publike	13,357	9.7%
	Institucione shëndetësore (QSH, Spitale, etj)	31,001	22.6%
	MSH ose institucione në varësi të saj (DSHP, ISHP)	6,621	4.8%
	OJF - Organizate Jo Fitimprurese	28,408	20.7%
	Shoqata profesionistësh	40,220	29.3%
	Tjetër	850	0.6%
	Urdhrat e profesionistëve	344	0.3%
<b>Totali - 2015</b>		<b>918,187</b>	<b>137,062</b>

4.2 **Farmacistët**

Farmacistët përfaqësojnë kategorinë me numrin më të lartë të profesionistëve me detyrimin minimal vjetor të kryer rreth 74%. Ofruesi kryesor i aktiviteteve ka qënë Urdhri i Farmacistëve është bërë e mundur plotësimi i kërkesave nga shumica e farmacistëve.

**a. Kreditet sipas fokusit të aktiviteteve.**

Vihet re se kreditet e marra nga aktivitete të lidhura me farmacinë zënë një % më të lartë se ato të marra nga aktivitete që nuk kanë në fokus farmacinë.

Shpërndarja e krediteve të profesionistëve sipas fokusit të aktivitetit			
Profesioni	Fokusi i Aktivitetit	Kreditet	%
Farmacist	Jo-Specialitet	4,681	14%
	Specialitet	29,417	86%
<b>Totali - 2015</b>		<b>34,417</b>	<b>100%</b>

**b. Kreditet sipas tipit të aktivitetit**

Pjesa më e madhe e krediteve janë marrë nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara nga Qendra Kombëtare Edukimit në Vazhdim. Një numër të papërfillshëm zënë aktivitetet e vetëraportuara. Në tabelën më poshtë jepet një situatë e hollësishme e shpërndarjes së krediteve sipas tipit të aktivitetit.

Shpërndarja e krediteve të profesionistëve sipas tipit të aktivitetit			
Profesioni	Tipi i Aktivitetit	Kreditet	%
Farmacist	Individuale	3,197	9%
	Të paraakredituara QKEV	31,220	91%
<b>Totali - 2015</b>		<b>34,417</b>	<b>100%</b>

**c. Kreditet sipas llojit të aktivitetit.**

Nga analiza e bërë për kreditet e marra sipas llojit të aktivitetit vërehet se përqindja më e lartë e krediteve është marrë nga konferencat, më pak nga trajnimet, aktivitete të pa përcaktuara e në fund janë leksionet. Një situatë më e qartë jepet në tabelën më poshtë.

Shpërndarja e krediteve sipas Llojit të Aktivitetit			
Profesioni	Lloji i Aktivitetit	Kreditet	%
Farmacist	Artikull	130	0.4%
	Konferencë	9,224	26.8%
	Leksion	14,537	42.2%
	Libër	169	0.5%
	On-line	4,704	13.7%
	Poster/Raport	30	0.1%
	Seminar	53	0.2%
	Tjetër	2,913	8.5%
	Trajnim	1,749	5.1%
	Trajnim në vendin e punës	42	0.1%
	Uorkshop	866	2.5%
<b>Totali - 2015</b>		<b>34,417</b>	<b>100%</b>

**d. Kreditet sipas ofruesit të aktivitetit.**

Vihet re se për kategorinë e farmacistëve pjesa më e madhe e krediteve janë grumbulluar nga aktivitete të organizuara nga Urdhri i Farmacistëve me 40%. Shuma e krediteve të grumbulluara nga aktivitetet e organizuara nga shoqata të profesionistëve zënë 20 % të totalit të krediteve.

Shpërndarja e krediteve sipas Kategorise se ofruesve te aktiviteve			
Profesioni	Kategoria e Ofruesit	Kredite t	%
Farmacist	Pa-Percaktuar	3,197	9.3%
	Institucione Akademike Private	1,138	3.3%
	Institucione Akademike Publike	3,135	9.1%
	Institucione shëndetësore (QSH, Spitale, etj)	877	2.5%
	MSH ose institucione në varësi të saj (DSHP, ISHP, etj)	159	0.5%
	OJF - Organizate Jo Fitimprurese	4,975	14.5%
	Shoqata profesionistësh	6,983	20.3%
	Tjeter	14	0.0%
	Urdhrat e profesionistëve	13,939	40.5%
<b>Totali - 2015</b>		<b>34,417</b>	<b>100%</b>

**4.3 Stomatologët**

Rreth 67% e stomatologëve e kanë kryer detyrimin e programit të certifikimit. Stomatologët që janë me 0 kredite arrijnë në shifrën 400 që do të thotë më shumë se 50% e totalit të gjithë profesionistëve.

**a. Kreditet sipas fokusit të aktiviteve.**

Vihet re se kreditet e marra nga aktivitete të stomatologëve zënë një % më të lartë se ato të marra nga aktivitete të jo-specialitetit.

Shpërndarja e krediteve të profesionistëve sipas fokusit të aktivitetit			
Profesioni	Fokusi i Aktivitetit	Kreditet	%
Stomatolog	Jo-Specialitet	5,591	12%
	Specialitet	39,301	88%
<b>Totali - 2015</b>		<b>44,892</b>	<b>100%</b>

**b. Kreditet sipas tipit të aktivitetit**

Pjesa më e madhe krediteve janë marrë nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara nga Qendra Kombëtare Edukimit në Vazhdim. Një numër të konsiderueshëm zënë aktivitetet individuale dhe më pak ato të vetëraportuara.

Shpërndarja e krediteve të profesionistëve sipas tipit tëaktivitetit			
Profesioni	Tipi i Aktivitetit	Kreditet	%
Stomatolog	Individuale	1,978	4%
	Të paraakredituara QKEV	42,914	96%
<b>Totali - 2015</b>		<b>44,892</b>	<b>100%</b>

**c. Kreditet sipas llojit të aktivitetit.**

Në ndryshim nga mjekët dhe farmacistët pjesën më të madhe të krediteve për stomatologët pothuajse 50% e zënë ato të marra nga konferencat. Në tabelën më poshtë shihet qartë shpërndarja e krediteve sipas llojit të aktivitetit.

Shpërndarja e krediteve sipas Llojit të Aktivitetit			
Profesioni	Lloji i Aktivitetit	Kreditet	%
Stomatolog	Artikull	15	0.0%
	Konferencë	28,857	64.3%
	Leksion	4,838	10.8%
	Libër	163	0.4%
	On-line	1,212	2.7%
	Poster/Raport	10	0.0%
	Seminar	934	2.1%
	Tjetër	1,805	4.0%
	Trajnim	6,852	15.3%
	Trajnim për Trajnerë	81	0.2%
	Uorkshop	125	0.3%
<b>Totali - 2015</b>		<b>44,892</b>	<b>100.0%</b>

#### d. Kreditet sipas ofruesit të aktivitetit.

Për kategorinë e stomatologëve vihet re se pjesa më e madhe e krediteve janë grumbulluar nga aktivitete të organizuara nga shoqata profesionistësh rreth 36 %. Vendin e dytë e zënë aktivitetet që e kanë të papërcaktuar kategorinë e ofruesit.

Shpërndarja e krediteve sipas Kategorise se ofruesve te aktiviteteteve			
Profesioni	Kategoria e Ofruesit	Kredite t	%
Stomatolog	Pa-Percaktuar	1,978	4.4%
	Institucione Akademike Private	3,971	8.8%
	Institucione Akademike Publike	3,578	8.0%
	Institucione shëndetësore (QSH, Spitale, etj)	1,785	4.0%
	MSH ose institucione në varësi të saj (DSHP, ISHP, etj)	555	1.2%
	OJF - Organizate Jo Fitimpruresë	9,616	21.4%
	Shoqata profesionistësh	22,537	50.2%
	Tjeter	869	1.9%

	Urdhrat e profesionistëve	3	0.0%
<b>Totali - 2015</b>		<b>44,892</b>	<b>100.0%</b>

#### IV. KOMUNIKIMI

QKEV gjatë vitit 2015 ka punuar për rritjen e sasisë dhe cilësisë të informacionit që marrin profesionistët duke iu ofruar asistencë në lidhje me kriteret, gjendjen aktuale të krediteve dhe detyrimet e programit të certifikimit, nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, postës elektronike, rrjeteve sociale, mediave si të shkruara ashtu dhe audiovizive.

- Profesionistët e shëndetësisë janë informuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me postë, postë elektronike për detyrimet, kreditet, ndryshimet e bëra në ligj, etj. Janë pritur një numër i konsiderueshëm profesionistësh të cilëve ju është shërbyer në kohë dhe me efikasitet duke i regjistruar në programin e certifikimit.
- Profesionistët të cilët janë licencuar për herë të parë janë regjistruar dhe orientuar për detyrimet, të drejtat sipas VKM .
- Profesionistët të cilët kanë qenë dhe janë pjesë e Programit të Certifikimit janë informuar në mënyrë të vazhdueshme për kreditet e marra dhe ato që detyrohen, duke shqyrtuar certifikatat e përfutuara nga aktivitetet e edukimit në vazhdim si brenda dhe jashtë vendit, duke u orientuar për plotësimin e formularit të vetëraportimit.
- Nëpërmjet postës u është dhënë përgjigje me shkrim të gjithë ankesave të profesionistëve drejtuar Qkev-së lidhur me Ciklin e Parë të Programit të Certifikimit.
- Janë bërë orientimet dhe janë njohur me Rregulloren e Provimit të Certifikimit të gjithë ata profesionistë të cilët nuk përmbushen detyrimet e Ciklit të Parë të Programit të Certifikimit.
- Në portalin elektronik të qendrës në mënyrë periodike janë pasqyruar të gjitha aktivitetet e akredituara nga Qkev, datat, vendet ku do të zhvillohen dhe gjithë të dhënat e duhura në mënyrë që profesionistët të kenë mundësi të rrisin dijet e tyre duke marrë pjesë në to.
- Në portalin elektronik të qendrës në mënyrë periodike janë pasqyruar të gjithë vendimet e marra mbledhjet e Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm.

- Janë pasqyruar në mënyre te qartë të gjithë ndryshimet ligjore të bëra nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë për sa u përket procedurave të certifikimit dhe akreditimit duke publikuar në kohë në portalin elektronik të Qendrës dhe nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me profesionistët.
- Në mënyrë periodike u janë kërkuar institucioneve shëndetësore publike dhe private listat e përditësuara të profesionistëve me të gjithë të dhënat për arsye të përmirësimit të Regjistrit Kombëtar të Certifikimit dhe u është dërguar informacion i detajuar për secilin nga ata ( nr.i krediteve, detyrimi në vite etj..)
- Është komunikuar në mënyre të vazhdueshme me Urdhrat Profesionalë për rifreskimin e listave të profesionistëve, atyre të lincencuar për here të parë, atyre të rilicencuar dhe ata të cilët kanë ndërprerë aktivitetin e tyre profesional.
- Vëmendje të vecantë ka marrë dhe mbajtja e kontakteve të ngushta me mediat e shkruara dhe audiovizive në mënyrë që të përçohet qartë dhe në kohë detyrimi që profesionistët e shëndetësisë kanë për edukimin e vazhdueshëm të tyre.